



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 15, datë 10/03/2004.

**PËR
STRUKTURËN ORGANIZATIVE DHË NIVELIN E PAGAVE TË DREJTORISË
NR. 3 TË PUNËTORËVE TË QYTETIT**

Në mbështetje të Ligjit 8652, dt. 31/07/2000, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore", neni 10, pika 3/II, (gërma "c"), 11, pika 3, gërma "a" e 32, gërma "ç", Ligjit Nr. 8487, datë 13/05/1999 "Për kompetencat në caktimin e pagave të punës", ndryshuar me Ligjin Nr. 8935, date 12/09/2002 "Për disa ndryshime në Ligjin 8487, datë 13/05/1999", neni 3, gërma "d", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 551, datë 07/11/2002 "Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore, për efekt page, përcaktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", pika 14, VKM-së Nr. 323, datë 14/06/1993 "Për kalimin e institucioneve feminare (çerdheve) në administrim të pushtetit lokal", pasi shqyrtoi Relacionin, të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Riorganizimin e Ndërmarrjes Komunale Banesa, Ndërmarrje me vetëfinancim në institucion buxhetor, në strukturën organizative të të cilës shtohen Sektori i DDD-së, Sektori i Vendstrehimeve (të shkëputura nga Drejtoria Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit) dhe krijohet Sektori i Mirëmbajtjes së Shkollave (i shkëputur nga Qendra Ekonomike Arsimit dhe Çerdheve), i cili do të jetë përgjegjës për funksionin e mirëmbajtjes së çerdheve dhe institucioneve parashkollore dhe shkollore.
2. Në mbështetje të pikës 1 të këtij Vendimi, miratohet ndryshimi i emërimit të Ndërmarrjes Komunale Banesa në Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit.
3. Në mbështetje të pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi, miratohet struktura organizative dhe numri i punonjësve (76), të Drejtorisë Nr. 3 të Punëtorëve të Qytetit sipas organigramës bashkëlidhur këtij Vendimi, si dhe të

hartohet Rregullorja e Organizimit dhe Funkcionimit të Drejtorisë dhe të paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak.

4. Miratimin e nivelit të pagave, të Drejtorisë Nr. 3 të Punëtorëve të Qytetit sipas Lidhjes Nr.4, bashkëlidhur këtij Vendimi.
5. Ngarkohet Qendra Ekonomike e Arsimit, Qendra Ekonomike e Çerdheve, Drejtoria Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit, Ndërmarrja Komunale Banesa dhe Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, për të kryer inventarët dhe veprimet e nevojshme kontabile e financiare që lidhen me zbatimin e pikës 1, të këtij Vendimi.
6. Zbatimi i pikës 1, 3 dhe 4 të këtij Vendimi, përfshirë dhe efektet financiare të tyre, do të fillojnë më datë 01/04/2004 dhe do të përballohen nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2004.
7. Vendimi Nr.42, datë 27/04/2001, si dhe të gjitha aktet dhe Vendimet e Këshillit Bashkiak që bien në kundërshtim me këtë Vendim shfuqizohen.
8. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike në Bashkinë e Tiranës, si dhe Qendra Ekonomike e Arsimit, Qendra Ekonomike e Çerdheve Drejtoria Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Ndërmarrja Komunale Banesa dhe Drejtoria Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit për zbatimin e këtij Vendimi.
9. Ky Vendim hyn në fuqi dhjetë ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI